



KRYETARI I KOMUNËS

NR-01- *11-1610*

ME DATE 17.01.2019

SH P A L L J E P U B L I K E

Për angazhimin e punëtorëve me marrëveshje për shërbime të veçanta. (Procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit)

Komuna e Suharekës duke u bazuar në Ligjin mbi marrëdhëniet e detyrimeve, Nr. 04/L-077 neni 615 i këtij Ligji, Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës neni 12 alineja 4, si dhe kërkesës së Drejtorisë për Ekonomi, Buxhet dhe Financa, përmes; Marrëveshjes për shërbime të veçanta (Kontrates) kërkon angazhimin e 20 (njëzet) punëtorëve për ofrimin e shërbimeve të veçanta për nevojat e kësaj Drejtorie të Komunës së Suharekës.

Kohëzgjatja e Marrëveshjes për shërbime të veçanta (Kontratës) është 1, (një) muaj.

Drejtorja për Ekonomi, Financa dhe Buxhet kërkon 20 (njëzet) zyrtar për shpërndarjen e faturave të tatimit në pronë për qytetin dhe të gjitha fshatrat e Komunës së Suharekës.

Detyrat dhe përgjegjësitë;

- Shpërndarja e faturave të tatimit në pronë e paluajtshme
- Kryerja e punëve të tjera të kësaj natyre sipas udhëzimeve të Drejtorit të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa të cilit edhe i raportojnë për punën e kryer.

Paga-e negociueshme

Kualifikimi:

- Përgatitje e mesme - universitare;
- Aftësitë kryesore, dituria, zotësia që kërkohet:**
- Të jete person me integritet të lartë personal dhe moral;
- Aftësi të mira komunikimi me qytetar;
- Njohuri të mira të punës;

Mënyra e aplikimit:

Kandidatët e interesuar duhet të paraqesin një biografi profesionale (CV), kopja e letërnjoftimit kopjet e dokumentacionit për kualifikimin. Dokumentacioni i kompletuar dorëzohet në Zyrën Pritëse të Komunës së Suharekës.

Shpallja mbetet e hapur 8 ditë nga dita e publikimit në tabelën e shpalljeve dhe në web faqen e Komunës së Suharekës.

Kandidatët të cilët hyjnë në përzgjedhje të ngushtë, do të informohen lidhur me intervistën (Negociimin) nëpërmjet telefonit ose me shkrim, në afat ligjor, Kandidatët të cilët do të jenë të përzgjedhur dhe të ftuar në intervistë (Negociim), duhet të sjellin për verifikim të gjitha dokumentet origjinale. Kërkesat e dërguara pas datës së fundit të mbylljes së shpalljes nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara do të refuzohen.

Komuna e Suharekës ofron mundësi të barabarta për të gjithë kandidatët e interesuar.

Kryetari i Komunës

Bali Muharemaj

